



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN**

**V E N D I M**

**Nr.1, datë 24.05.2022**

**PËR**

**SHFUOIZIMIN E LEJES NR. VI/9, DATË 17.02.2010, TË KËSHILLIT TË  
BASENIT UJËMBLEDHËS SHKUMBIN-DEVOLL, "PËR PËRDORIM  
REZERVE UJORE PËR NDËRTIMIN E HEC-eve "URA E PRRENIT" NË  
RRJEDHËN E PËRROIT BUSHTRICË, LIBRAZHD**

Në mbështetje të pikës 6, të nenit 50, shkronjës“e”, të nenit 55, të ligjit nr.111, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

**KONSTATOI SE:**

Shoqëria koncesionare “Elenergji” shpk dhe shoqëria “Bushtrica 2017” shpk kanë aplikuar pranë Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman (ZABU) për pajisjen me leje për përdorim burimi ujqor përkatësisht për HEC “Bushtrica 1” dhe “HEC Bushtrica 2”. Gjatë procedurës së verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm teknik e ligjor të paraqitur nga këto subjekte, është konstatuar se Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin-Devoll në të njëjtat koordinata ka miratuar lejen “Për përdorim rezerve ujore” me nr.VI/9, datë 17.2.2010 në favor të shoqërive “LNK” shpk, “Erniku” shpk, “ASK Oil” shpk dhe “Loshi BL” shpk me afat sipas kontratës të Ministrisë.

Nga ana e shoqërive “Elenergji” shpk dhe “Bushtrica 2017” shpk është vënë në dispozicion një kopje e shkresës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me nr. 1856/3 prot., datë 27.2.2017, “Njoftim për ndërprerje dhe zgjidhje të njëanshme të kontratës së koncesionit për ndërtimin e HEC-eve mbi rrjedhën e lumit Bushtricë-Librazhd (Ura e Prenit)”, me anë të së cilës MEI ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën koncesionare Nr.2829 Rep., Nr.373 Kol., datë 3.9.2009, të formës “BOT” të lidhur me bashkimin e përkohshëm të shoqërive “LNK” shpk, “Erniku” shpk “ASK Oil” shpk dhe “Loshi BL” shpk për ndërtimin e HEC-eve në rrjedhën e lumit Bushtricë (HEC-et Ura e Prenit), të ndryshuar me shtesën e koncesionit Nr.9973 Rep., Nr. 3166 KOL., datë 27.8.2013.

Me shkresën nr. 1277 prot., datë 13.9.2019, ZABU Shkumbin-Seman i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) duke i kërkuar informacion nëse ka kontrata të lidhura më parë ose janë në proces për shfrytëzimin e burimit ujqor të lumit të Bushtricës, degë e lumit Shkumbin, për prodhim energjie elektrike.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, MIE me shkresën nr.8037/3 prot., datë 11.12.2019, ka informuar se për shfrytëzimin e lumit Bushtricë, degë e lumit Shkumbin, janë lidhur këto kontrata koncesionare:

- Kontrata Koncesionare e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit Bushtrica 1", nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë koncesionare "Elenergji" sh.p.k., e cila shfrytëzon lumin Bushtricë nga kuota 498 m m.n.d. deri në kuotën 380 m m.n.d.
- Kontrata Koncesionare e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit Bushtrica 2", nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë koncesionare. "Bushtrica 2017" sh.p.k., e cila shfrytëzon lumin Bushtricë nga kuota 593; 845 m.n.d., deri në kuotën 500 m m.n.d.
- Kontrata Koncesionare e formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit "Bushtrica 3", nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë koncesionare "Bushtrica Hydropower" sh.p.k., e cila shfrytëzon lumin Bushtricë nga kuota 820; 820 m m.n.d. deri në kuotën 596 m m.n.d.

Sa më sipër, rezulton se kontrata koncesionare e lidhur midis MIE dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive "LNK" shpk, "Erniku" shpk "ASK Oil" shpk dhe "Loshi BLështë zgjidhur në mënyrë të njëanshme dhe nga ana e këtij institucioni janë lidhur kontratat koncesionare të cituara më sipër. Gjithashtu pranë Zyrës së Administrimit Shkumbin-Seman nga ana e subjekteve të cilët kanë lidhur kontratat koncesionare aktualisht në fuqi është bërë aplikim për pajisjen me leje për përdorim burimi ujor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 6, të nenit 50, shkronjës"e", të nenit 55, të ligjit nr.111, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

#### **V E N D O S I:**

1. Shfuqizimin e vendimit nr. VI/9, datë 17.02.2010, të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Shkumbin-Devoll, "Për miratimin e lejes përdorim të rezervës ujore për ndërtimin e HEC-eve "Ura e Prenit" në rrjedhën e përroit Bushtricë, Librazhd.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.

